




KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 154 – Shtator – 2016 – Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamje nga vizita e delegacionit nga qyteti i Sundernit (Gjermani), në Malishevë



Përmbajtja:

Komuna e Malishevës mbajti dëgjimin publik për buxhet	3
MMPH ndau pesëdhjetë mijë euro për riparimin e digës në liqenin e Mirushës.....	4
Hapet shkolla e Gurishtës	5
Filloi ndërtimi i shkollës “Rifat Berisha” në Berishë.....	6
Trupa e aktorëve të rinj, dha shfaqjen teatrale “Ehh...LETRAT”	7
Komuna vazhdon përkrahjen për bletarët.....	7
Mediat në Maqedoni, të mos luajnë me fatkeqësinë e njerëzve tanë.....	8
Deri më tani tetë raste të regjistruara të kafshëve me sëmundjen gungore	9
Digjitalizohet shkolla e Bellanicës	10
U prezantua Plani Zhvillimor Komunal 2017-2025 për Malishevën	11
Banorët e Dragobilit dhe Burimit, kundërshtojnë ndërtimin e fabrikës për asgjësimin mbeturinave, barnave dhe mbetjeve spitalore.....	12
KKSB mbështet organet e rendit në ndriçimin e rasteve kriminale.....	13
Po punohet në të gjitha projektet	14
U mbajt një shqyrtim publik për vlerësimin e rrezeve.....	15
KPF shqyrtoi projekt buxhetin komunal për vitin 2017	16
Drejtorët e shkollave, të pakënaqur me furnizimin me libra në shkolla	16
Megan DiGirolamo, nderohet për punën e saj në arsimin malishevas	17
Në Ditën e Rinisë, jepen mesazhe të shumta	18
Gjatë javës pritet të përfundojnë disa projekte.....	19
Filloi asfaltimi i rrugëve në Panorc.....	20
Të gjitha lagjet e Drenocit, do të lidhen në rrjetin e kanalizimit	20
KK i Malishevës mbajti mbledhjen e nëntë të rregullt.....	21
Kuvendi i të Rinjve, mbajti mbledhjen e gjashtë të radhës	22
Një delegacion nga Sunderni, po qëndron në Malishevë	23
KK i Malishevës, nuk ka miratuar projekt buxhetin 2017-2019.....	24



Komuna e Malishevës mbajti dëgjimin publik për buxhet

Malishevë, 2 shtator



Komuna e Malishevës, sot në sallën e Kuvendit të Komunës, ka mbajtur dëgjimin publik me qytetar dhe përfaqësues të fshatrave, për projekt buxhetin komunal 2017-2019, me theks të veçantë, për buxhetin e vitit 2017, ku u prezantua qarkorja e dytë buxhetore dhe morën kërkesat e të gjitha vendbanimeve, për hartimin e prioriteteve për investime kapitale. Sipas përgjegjësve komunal, orientimi për vitin e ardhshëm, do të jetë ndërtimi i tri

objekteve shkollore dhe rritja e investimeve në bujqësi, ndërsa në investimet e infrastrukturës, përparësi do të kenë lagjet që janë tatimpagues më të mirë.

Për qëllimin e këtij dëgjimi, të pranishmit i informoi kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili tha se edhe këtë vit, prioritetet e komunës, do të bëhen nga kërkesat e vet vendbanimeve. Duke folur për investimet e deritanishme, kryetari Begaj, tha se “jemi munduar që deri diku ti plotësojmë kërkesat që kanë ardhur nga vendbanimet, por e di se jo të gjitha nevojat mund të plotësohen, mirëpo angazhimi ynë nuk ka munguar, sikur nuk do të mungoj as në të ardhmen”.

Qarkoren e dytë buxhetore, para të pranishmëve, e prezantoi drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, Vesel Krasniqi. Drejtori Krasniqi, e paraqiti buxhetin në vija të trasha, ndërsa tha se “buxheti i ndarë për investime kapitale, do të jetë rreth katër milion euro, ku prioritet i menduar për investime, do të jetë përfundimi i objekteve shkollore që kanë filluar tani dhe ndërtimi i tri objekteve tjera shkollore, pastaj rëndësi e veçantë do ti kushtohet bujqësisë, por nuk do të mbesin anash as investimet në infrastrukturë”. Për investimet në infrastrukturë, ku sipas Krasniqit, shihet një garë mes lagjeve, tha se “prioritet do të kenë lagjet që janë tatimpaguese më të rregullta”.

Pas prezantimit, është zhvilluar edhe debat, ky kryesisht përfaqësuesit e fshatrave, i kanë paraqitur nevojat dhe kërkesat e tyre, për ti futur në prioritetet komunale për vitin e ardhshëm, e ku si zakonisht kanë dominuar kërkesat për investime në infrastrukturë, si infrastruktura shkollore, rrugore, ujësjellës dhe kanalizimi, e në mesin tyre, tri shkolla dhe dy rrugë që lidhin fshatrat.



Përveç përfaqësuesve të fshatrave, edhe qytetarët të tjerë i kanë paraqitur mendimet e tyre, lidhur me ndarjet buxhetore dhe investimet, ku kanë kërkuar investime të planifikuara dhe afatgjate, si dhe rritje të cilësisë, sidomos në projektet e infrastrukturës.

Të gjitha pyetjeve dhe të gjitha sqarimet, i ka dhënë kryetari Begaj dhe drejtorët e drejtorive, varësisht prej diskutimeve të të pranishmëve, ndërsa kryetarët e vendbanimeve, kërkesat e tyre për investime, i kanë bërë edhe me shkrim.

MMPH ndau pesëdhjetë mijë euro për riparimin e digës në liqenin e Mirushës

Malishevë/Prishtinë, 2 shtator



Sot në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), është nënshkruar një memorandum mirëkuptimi mes kësaj ministrie dhe Komunës së Malishevës, përkatësisht mes u.d. i ministrit të MMPH, z.Ferat Shala dhe kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, për investim në rregullimin e digës së liqenit në Mirushë. Shuma e ndarë nga kjo ministri, është pesëdhjetë mijë euro, ndërsa pjesa tjetër e investimit do të mbulohet nga Komuna e Malishevës.

Këtë përkrahje të kësaj ministrie, e ka konfirmuar kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili ka njoftuar se sot e kanë nënshkruar këtë marrëveshje me u.d. të ministrit të MMPH, Ferat Shala.

Diga në liqenin në Mirushë, ishte dëmtuar për shkak të dy vërshimeve të mëdha që patën ndodhur në territorin e Komunës së Malishevës, e si pasojë e këtyre vërshimeve, diga kishte pësuar dëmtime të rënda. Riparimi i digës, bëhet me qëllim evitimit të rrezikut të mundshëm të shpërthimit të saj, e që do të kishte pasoja të mëdha për fshatrat poshtë liqenit, si Mirusha, Lumnishta, Turjaka e Bublë.

Komuna e Malishevës, gjatë vërshimeve në janar të këtij viti, kishte pësuar dëme të mëdha, të cilat ishin llogaritur në afro një milion euro, por dëmtimi i digës së liqenit, paraqiste rrezik të madh.



Hapet shkolla e Gurishtës

Malishevë, 5 shtator



mysafir të tjerë.

Sot, në ditën e parë të fillimit të vitit të ri shkollor, fshati Gurishtë, u bë me shkollë të re. Ceremonia zyrtare e hapjes së objektit të ri shkollor, u bë në ora 10:00, në të cilën morën pjesë kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kryesuesi i KK të Malishevës, Aziz Thaçi, drejtori i arsimit në Malishevë, Avdi Morina, zyrtarë tjerë të qeverisë komunale, nxënësit dhe arsimtarët e kësaj vatre shkollore, banorë të Gurishtës dhe

“Fillimi i vitit të ri shkollorë, është një festë, por më të bukur këtë festë sot, e bënë ky objekt i ri i shkollës suaj. Ju nxënës dhe arsimtarë e gëzofshi këtë shkollë”, tha në fjalën rastit kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Duke folur për rëndësinë e cilësisë në shkollim, kryetari Begaj, tha, se “baza e zhvillimit të një vendi është arsimit cilësor dhe ne jemi të përkushtuar që të rrisim cilësinë, përmes krijimit të kushteve sa më të mira për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Juve arsimtar të kësaj shkolle, ju mbetet të punoni sa më shumë, pasi vetëm me punë ne mund ta ndërtojmë vendin tonë, e ju më së miri mund ta bëni këtë, duke na dhënë kuadro të reja të përgatitura mirë. Të punosh për vendin është përgjegjësi e të gjithëve”, tha Begaj.

“Në emër të drejtorisë komunale për arsim, ju uroj për objektin e ri të shkollës suaj dhe ju uroj për fillimin e vitit të ri shkollor 2016/17. Është përgjegjësi e jona, që të krijojmë kushte sa më të mira dhe këtë jemi duke e bërë, përmes investimeve në arsim”, tha drejtori i drejtorisë për arsim, Avdi Morina.

Ndërsa për historikun e shkollës, foli drejtori i shkollës fillore dhe të mesme të ulët “Nuhi Mazreku” në Gurishtë, Xhevdet Mazreku, i cili në mënyrë kronologjike, kujtoi rrugëtimi e kësaj shkolle, deri në pavarësimin e saj, më 2008, ku edhe mori emrin Nuhi Mazreku, ish mësues i kësaj shkolle, tani dëshmor i kombit.

Shiritin e përrurimit e prenë, kryetari Begaj, së bashku me familjarët e dëshmorëve të kombit, Nuhi Mazreku dhe Hidajet Mazreku, kryesuesi i KK të Malishevës, Aziz Thaçi dhe drejtori i arsimit, Avdi Morina.

Ndërtimi i këtij objekti modern, është financuar nga buxheti komunal i Malishevës dhe ka kushtuar rreth 300 mijë euro.



Filloi ndërtimi i shkollës “Rifat Berisha” në Berishë

Malishevë, 5 shtator



Në kuadër të investimeve në infrastrukturën shkollore në Komunën e Malishevës, dhe me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2016-2017, sot kanë filluar punimet në ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe të mesme të ulët “Rifat Berisha” në Berishë. Në ceremoninë e vënies së gurëthemelit, krahas banorëve, nxënësve dhe stafit arsimor të shkollës, morën pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kryesuesi i KK të Malishevës, Aziz Thaçi, drejtori i arsimit

Avdi Morina, drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, si dhe familjarë të Rifat Berishës.

“Jam shumë i kënaqur me rastin e fillimit të ndërtimit të kësaj shkolle, e cila mbanë emrin e Rifat Berishës. Kontributi dhe gjaku i derdhur i dëshmorëve të kombit, siç ishte Rifati dhe dëshmorët tjerë, na kanë mundësuar neve, që sot të ndërtojmë shkolla si kjo. Me punë dhe arsimim, ne e nderojmë kontributin e dëshmorëve dhe shumë e shumë atdhetarëve, që kanë punuar e luftuar deri në ditët e sotme”, tha në fjalën e rastit kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Xhezair Berisha, nga familja e Rifat Berishës, në emër të familjes Berisha, e falënderoi Komunën e Malishevës, për ndërtimin e këtij objekti shkollor, që me krenari mbanë emrin e Rifat Berishës.

Ndërsa drejtori i SHFMU “Rifat Berisha” në Berishë, Lulzim Gegaj, tha se “sot është një moment i veçantë për të gjithë nxënësit dhe mësuesit e kësaj shkolle, pasi po fillon ndërtimi i një shkolle moderne, me kushte shumë më të mira për mësim dhe me hapësirë të mjaftueshme për të gjithë nxënësit e kësaj ane”.

Drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, ka thënë se objekti dhe punimet tjera që kryhen këtu, do ti kushtojnë buxhetit komunal rreth 200 mijë euro.



Trupa e aktorëve të rinj, dha shfaqjen teatrale “Ehh...LETRAT”

Malishevë, 6 shtator



Sot në shtëpinë e kulturës, u dha shfaqja e parë e grupit të aktorëve të rinj të Komunës së Malishevës, “Ehh...LETRAT”, shfaqje e cila u vlerësua nga publiku, si artdashës, ashtu edhe profesionist, që ishin prezent. Grupi i aktorëve të rinj, është formuar javë më parë, ndërsa kjo ishte shfaqja e parë teatrale.

Në këtë shfaqje, u trajtua tema aktuale e braktisjes së shkollimit dhe punës në vend, me qëllim të kërkimit të një jete më të mirë në vende tjera. Tema të cilën e

kanë zgjedhur, është shkruar nga vet të rinjtë, ndërsa regjinë e shfaqjes e ka bërë regjisorja Alma Bekteshi.

Pas shfaqjes, është zhvilluar edhe një debat mes aktorëve të shfaqjes dhe publikut, lidhur me paraqitjen e tyre dhe karakteret e kësaj shfaqje, ku publiku, përveç pyetjeve, i ka dhënë edhe mendimet e tyre lidhur me prezantimin, ku u vlerësuan lartë, për aktrimin, por edhe për tematikën e trajtuar.

Komuna vazhdon përkrahjen për bletarët

Malishevë, 8 shtator

Edhe këtë vit, Komuna e Malishevës, ka vazhduar përkrahjen për bletarët lokal, përkatësisht për ata bletarë, të cilët kanë më pak se tridhjetë shoqëri bletësh dhe nuk mund të përfitojnë nga donacionet e ministrisë së bujqësisë. Këtë kategori të bletarëve, rreth 150 prej tyre, i ka përkrahur komuna, duke ju shpërndarë koshere dhe centrifuga.

Sipas drejtorit të bujqësisë, në Komunën e Malishevës, Haxhi Krasniqi, “në kuadër të përkrahjes në bujqësi, edhe sektori i bletarisë është përkrahur me mjete konkretizuese, përkatësisht me



koshere dhe centrifuga, ku përfitues janë 140 bletarë me koshere dhe dhjetë të tjerë me centrifuga”.



Për këtë qëllim, Komuna e Malishevës, ka dhënë një fond prej 12 150 euro, ku do të shpërndahen 250 koshere bletësh dhe dhjetë centrifuga, duke i përkrahur bletarët, të cilët nuk kanë mundësi të aplikojnë për subvencione në grantet qeveritare, pasi kanë më pak se tridhjetë shoqëri bletësh.

Sipas, kryetarit të Shoqatës së Bletarëve të Malishevës, Sali Bytyçi, “në Komunën e Malishevës, përkatësisht të anëtarësuar në këtë

shoqatë janë afro dyqind anëtarë, me rreth tre mijë shoqëri bletësh dhe çdo përkrahje për bletarët është e mirëseardhur”.

Bazuar në të dhënat e shoqatës, në kushte normale të prodhimit, kjo sasi e shoqërive të bletëve, mund ti përmbushë nevojat e Komunës së Malishevës me mjaltë, gati njëqind për qind, edhe pse në dy vitet e fundit, ka qenë vit i brishtë për bletë, pasi nuk ka pasur sasi të mjaftueshme të mjaltit”.

Reagim ndaj kronikës së ALSAT M

Mediat në Maqedoni, të mos luajnë me fatkeqësinë e njerëzve tanë

Malishevës, 9 shtator

Televizioni ALSATM, me datë 08.09.2016. në ora 16:00, ka publikuar në faqen e saj zyrtare në internet, një kronikë lidhur me ngjarjen tragjike të rrëzimit të aeroplanit, ku në mesin e gjashtë viktimave, ka humbur jetën edhe Visar Begaj, nga Banja e Malishevës. Në këtë kronikë, ky televizion, ka dhënë një të pavërtetë lidhur me Ambasadën dhe ambasadorin e Kosovës në Maqedoni, z.Ylber Hysa, se gjoja “ambasadori nuk ka kërkuar që trupi i pajetë i Visar Begajt, të kthehet në vendlindje”, ndërsa në kronikë përmendet edhe deklarata e Kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Për hir të së vërtetës, informojmë publikun e gjerë, familjen Begaj dhe të gjitha mediat tjera, se ambasadori Hysa, nga momenti i fatkeqësisë, ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me Komunën e Malishevës, kryetarin Begaj dhe familjen Begaj nga Banja. Gjithashtu, edhe ministri i Ministrisë



së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj, ka qenë në kontakt me Komunën e Malishevës dhe kryetarin Begaj, dhe për këtë ne i falënderojmë.

Po ashtu, ju bëjmë me dije, të gjitha mediave dhe ALSATM, se ambasadori Hysa, është angazhuar dhe vazhdon të jetë i angazhuar, që trupi i pajetë i Visar Begajt, ti kthehet familjes, në Banjë.

“Ne nuk e dimë dhe nuk e kuptojmë qasjen e këtyre mediave në Maqedoni, përfshi edhe ALSATM, ndaj nesh, por kërkojmë nga ambasadori Hysa, që të mos shqetësohet, pasi këto media, kanë mundur ti shpallin të vdekur dy vëllezër dhe nuk kanë qenë në gjendje të kërkojnë falje për shqetësimin dhe dezinformatën, kurse skandali i dytë i tyre, është më i vogël se i pari “, deklaroi kryetari Begaj, lidhur me kronikën e televizionit ALSATM.

Mediat në Maqedoni, përfshi edhe televizionin ALSATM, kanë qenë të parat që kanë dezinformuar, se në këtë fatkeqësi, kanë humbur jetën dy vëllezërit Begaj, duke shqetësuar familjen dhe Komunën e Malishevës.

Deri më tani tetë raste të regjistruara të kafshëve me sëmundjen gungore

Malishevë, 13 shtator

Drejtorja e Inspektoratit, ka bërë të ditur, se deri më tani në territorin e Komunës së Malishevës, janë regjistruara tetë raste të sëmundjes gungore të kafshëve. Kjo është bërë e ditur në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të mbajtur sot. Ndërsa sa i përket situatës epidemiologjike nga EHKK, u bë e ditur, se janë ulur të gjitha masat, pasi tani, pothuajse nuk ka fare raste të thumbimeve nga rriqrat.

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, duke drejtuar mbledhjen e sotme të rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ka kërkuar që të vazhdohet me projektet e planifikuara, si dhe kërkoi nga drejtoritë që të vazhdojnë me ecurinë e programeve të tyre dhe planifikimeve të bëra për këtë vit, duke mos lejuar që të shkaktohen vonesa në realizimin e tyre.

Drejtori i Inspektoratit, Fadil Shala, ka bërë të ditur se “inspektorët komunal, janë në përcjellje të vazhdueshme të sëmundjes gungore të kafshëve, dhe gjatë javës së kaluar, janë regjistruar katër raste të reja, duke e rritur numrin në tetë raste gjithsejtë (edhe pse deri para dy javëve, territori i Malishevës, nuk ishte i prekur nga kjo sëmundje)”. Po ashtu Shala, ka bërë të ditur, se inspektorët kanë qenë shumë aktiv ditëve të fundit, duke i kontrolluar të gjitha dyqanet dhe marketet.



Ndërsa drejtori i shëndetësisë, Hajdin Berisha, duke raportuar në mbledhjen e sotme, njoftoi se zyrtarisht, pas mbledhjes së fundit të Këshillit Ndërministror, për luftimin dhe parandalimin e EHKK, janë ulur masat sa i përket kësaj sëmundje, pasi përveç faktit se nuk kemi pasur raste të prekura nga ethet hemorragjike, edhe rastet e thumbimeve nga rriqrat kanë rënë, pothuajse në zero, dhe rrjedhimisht është ulur edhe gjendja gatishmërisë.”Mund të themi lirisht se kemi kaluar edhe një vit të suksesshëm në këtë drejtim”, tha Berisha.

Sa i përket investimeve kapitale dhe realizimit të projekteve, drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, ka bërë të ditur se është duke u vazhduar në realizimin e projekteve dhe disa tjera janë në proces e sipër të fillimit të punimeve. Drejtori Morina, po ashtu ka bërë të ditur se në tri projekte, ka pengesa pronësore por të cilat do të tejkalohen dhe projektet do të realizohen brenda afateve të parapara.

Kurse në arsim, drejtori i arsimit në Malishevë, Avdi Morina, tha se këtë javë, do të fillohet me aplikimin e mësimit përmes monitorëve, dhe ky projekt do të fillojë të realizohet në Sh.F.M.U. “Ismail Qemali” në Bellanicë.

Digjitalizohet shkolla e Bellanicës

Malishevë, 15 shtator



Në Komunën e Malishevës, procesi mësimor ka filluar në të gjitha shkollat, mirëpo e veçantë e këtij viti, është edhe një pilot projekt i ri, i digjitalizimit të shkollave, ku nxënësit përveç mësimit që do ta marrin përmes shpjegimit klasik, do të kenë mundësi që të mësojnë edhe përmes monitorëve të vendosur në klasa. Kjo formë e mësimit ka filluar të aplikohet në Sh.M.U. “Ismail Qemali” në Bellanicë.

Po ashtu kjo shkollë, ka përfutur edhe një kabinet të informatikës, falë një donacioni nga mërgimtari Bashkim Ferat Shala nga Guncati, i cili ka kompletuar kabinetin e informatikës me kompjuter, në mënyrë që nxënësit të mësojnë në mënyrë praktike.

Për këtë qëllim, sot këtë shkollë, e kanë vizituar kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i arsimit, Avdi Morina, të cilët janë njoftuar me këtë formë të re të organizimit të



mësimin. Me këtë rast, kryetari Begaj dhe drejtori Morina, i kanë përgëzuar mësimdhënësit dhe nxënësit, për këtë formë moderne të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Po, ashtu Begaj, Morina, dhe drejtori i shkollës Isuf Sertolli, e kanë falënderuar bashkatdhetarin Shala, për këtë ndihmë në kompletimin dhe futjen në funksion të kabinetit të informatikës, si dhe për ndihmën e vazhdueshme të tij.

U prezantua Plani Zhvillimor Komunal 2017-2025 për Malishevën

Malishevë, 15 shtator



Sot në Malishevë, është bërë prezantimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2017-2025. Nga sot ky dokument strategjik për zhvillimin e Komunës së Malishevës, do të jetë në diskutim publik. Përndryshe PZHK, u vlerësua si një dokument shumë mirë i përgatitur, ndërsa sipas folësve, Malisheva, është komuna e parë që e harton këtë plan zhvillimor, në hartim të plotë me ligjin e ri për planifikim hapësinor.

Fillimisht, kryetari i Komunës së Malishevës, i falënderoi të gjithë ata që janë angazhuar në hartimin e PZHK, duke filluar nga ekipi i ekspertëve komunal, pastaj UNHABITAT-in, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPLH) dhe të tjerët. Ndërsa këtë dokument e vlerësoi si shumë të rëndësishëm për zhvillimin e Malishevës.

Suzana Godanci nga MMPH, tha se kjo i paraprinë miratimit të një prej dokumenteve më me rëndësi për Malishevën, si dhe tha se Malisheva është komuna e parë që e bënë këtë planifikim në bazë të ligjit të ri dhe gjithëpërfshirës.

Edhe Gwehdoline Mennetrier nga UNHABITAT, e vlerësoi lartë punën profesionale të ekipit që ka hartuar këtë plan zhvillimor dhe vet këtë dokument e quajti si shumë të rëndësishëm, ndërsa edhe kjo tha se Malisheva është komuna e parë që e harton këtë plan në bazë të ligjit të ri për planifikim hapësinor.

Drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina e vlerësoi planin si një dokument me rëndësi të veçantë, që do ta ndihmojë zhvillimin e Malishevës dhe i ftoi të gjithë, që të japin kontributin e tyre në përfundimin e këtij dokument me rëndësi.



Më pas, inxhinierja Valdete Morina, udhëheqëse e ekipit komunal që ka hartuar PZHK, e bëri prezantimin e këtij plani, duke filluar nga procesi i hartimit e deri në hartimin përfundimtar, gjendja ekzistuese, objektivat, sfidat dhe të gjithë planin e hartuar nga ekipi komunal. Po ashtu, Morina, tregoi se nga sot, ky plan, është në shqyrtim publik dhe njoftoi që i gjithë plani është i publikuar në ueb faqen e komunës, ndërsa qytetarët, shoqëria civile dhe të gjitha grupet e interesit, mund të japim mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre përmes postës elektronike, ose direkt në zyrat komunale. Gjithashtu, u bë e ditur se dëgjime publike do të mbahen edhe në katër vendbanime tjera të Malishevës dhe në fund, do të merren të gjitha mendimet e dhëna, për ta hartuar dokumentin final, para miratimit në Kuvendin e Komunës dhe në fund, do të bëhet kërkesa për pëlqim në MMPH.

Banorët e Dragobilit dhe Burimit, kundërshtojnë ndërtimin e fabrikës për asgjësimin mbeturinave, barnave dhe mbetjeve spitalore

Malishevë, 15 shtator

Sot në Malishevë, është organizuar një debat publik, lidhur me raportin e vlerësimit për ndikimin në mjedis, për fabrikën për asgjësimin dhe riciklimin e mbeturinave, në Dragobil, Komuna e Malishevës. Ky debat ishte organizuar nga “Princi Company” si investitor dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë. Në këtë debat, banorët e Dragobilit dhe të Burimit, e kundërshtuan ashpër ndërtimin e kësaj fabrike, pasi në raportin e prezantuar, u tha se do asgjësohen barnat e skaduara dhe mbetjet spitalore.

Hartuesi i raportit, Rraif Bytyçi, i cili prezantoi raportin e bërë, megjithatë, nuk dha përgjigje në shumë prej pyetjeve të bëra nga banorët, qoftë për largësinë mes fabrikës dhe vendbanimit, qoftë për filtrin e paraparë të përdorët, sikur nuk dha përgjigje për gjendjen e ujërave, përkatësisht burimeve të ujit, edhe pse të gjitha këto, sipas banorëve, do të duhej të përfshiheshin në raport.

Mirëpo, ajo që ishte më interesante, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës, të cilët kanë miratuar kërkesën e kompanisë në fjalë, për ndarjen e një lokacioni për ushtrimin e veprimtarisë, thanë se nuk kanë qenë të njoftuar lidhur aktivitetin e kompanisë. Edhe pse zyrtarët e kompanisë deklaruan të kundërtën, anëtarët e Kuvendit të Komunës, prezent në debat, ofruan procesverbalet, përmes së cilave, vërtetohet se kanë votuar diçka tjetër, e jo për ndërtimin e një fabrike për asgjësim të barnave dhe mbetjeve spitalore.

Në raportin e prezantuar, nuk u paraqit as ndonjë plan veprimi për raste emergjente, ku do të mund të shkaktohej ndotje në masë e ambientit.



Përfaqësuesi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, Shukri Shabani, tha se ministria do ti zbatoj rregullat dhe procedurat e saj, para dhënies ose mosdhënies të pëlqimit për ndërtimin e kësaj fabrike.

Gjatë debatit, banorët e të dy fshatrave, u shprehën kategorik, për mos lejimin e ndërtimit të fabrikës për këtë lloj veprimtarie, dhe për këtë gjë kërkuan nga ministria, por edhe nga organet komunale, që ta ndalojnë, në të kundërtën, për shkak të afërsisë së vendbanimit, banorët do të duhet të reagojnë në të gjitha format e mundshme për mbrojtjen se jetës së tyre nga ndotja që mund të shkaktohet.

KKSB mbështet organet e rendit në ndriçimin e rasteve kriminale

Malishevë, 16 shtator

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), ka mbajtur mbledhjen e rregullt të saj, ku është shqyrtuar situata e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Malishevës. KKSB, iu dha mbështetje të plotë organeve të rendit për ndriçimin e rasteve kriminale apo dukurive negative.

Përndryshe, KKSB e vlerësoi se gjendja a e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Malishevës, është stabile dhe e qetë, dhe pa tendencë për destabilizimin e saj, edhe përkundër shfaqjes së disa dukurive negative të ndodhura kohës së fundit. KKSB inkurajon dhe mbështet plotësisht organet e rendit në ndriçimin e këtyre dukurive, apo rasteve kriminale, siç ishte rasti i vrasjes gjatë javës së kaluar.

Gjithashtu, KKSB-ja , rekomandoi Komitetin për Politikë dhe Financa, që ta shqyrtoj mundësinë për dhënie e dritës së gjelbër për implementimin e projektit për “Videovëzhgimin e Hapësirave Publike” në kuadër të Qendrës Operative Komunale Emergjente në qytetin e Malishevës.

Gjatë takimit janë shqyrtuar edhe çështje të tjera, si Shërbimet Publike, Urbanizmi, Shëndetësia dhe Arsimi.



Po punohet në të gjitha projektet

Malishevë, 19 shtator

Këshilli i Drejtorëve, i drejtuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të së hënës, ku është diskutuar për të gjitha çështjet e drejtorive, projektet, planifikimet dhe çështje tjera. Në këtë mbledhje, bazuar në deklaratimet e drejtorëve të drejtorive komunale, u tha se “po vazhdojnë punimet në të gjitha projektet, si në infrastrukturë, ashtu edhe në bujqësi dhe fusha tjera”.

Drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, tha se janë duke vazhduar punimet në të gjitha projektet, ndërsa ka filluar rregullimi i oborrit të shkollës në Gurishtë, pastaj trotuari në Drenoc, si dhe brenda javës pritet të filloj rregullimi i kanalizimit në Drenoc dhe kanalizimi i ujërave atmosferik, në hyrje të Malishevës.

Edhe drejtori i bujqësisë, Haxhi Krasniqi, tha se po vazhdojnë projektet në bujqësi, përfshi edhe ndërtimin e stallave. Ndërsa drejtori i shërbimeve publike, Milazim Morina, tha se po punohet në hapjen e disa kanalizimeve të bllokuara, si dhe paraqiti nevojën e pastrimit të përroskës që kalon nëpër qytet. Morina, po ashtu tha se kanë filluar edhe përgatitjet për sezonin e dimrit, përkatësisht për mirëmbajtjen e rrugëve.

Në këtë mbledhje u njoftua edhe për fillimin e vaksinimit të gjedhëve kundër sëmundjes gungore të kafshëve, proces i cili po ecën mirë në këto ditë të para.

Në fushën e shëndetësisë, nga drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha, u paraqit edhe shqetësimin për rastet e shpeshta që janë paraqitur këtë vit, të thumbimit nga bletët dhe grerëzat, të cilat tek disa njerëz manifestohet me alergji. “Vetëm gjatë ditës së djeshme, në QKMF të Malishevës, janë regjistruar katër raste të rënda me alergji, si pasojë e thumbimit nga bletët dhe grerëzat”, tha drejtori Berisha.

Sa i përket buxhetit, drejtori për buxhet, Vesel Krasniqi, deklaroi se projekt buxheti për vitin 2017, është i gatshëm dhe të njëjtin e ka dorëzuar në komitet për politikë dhe financa, ndërsa pritet të kaloj në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.



U mbajt një shqyrtim publik për vlerësimin e rreziqeve

Malishevë, 20 shtator



Organizuar nga OSBE dhe Drejtoria për Urbanizëm, sot në Malishevë, u mbajt një shqyrtim publik i Planit Zhvillimor Komunal, me theks të veçantë për aspektin e vlerësimit të rreziqeve. Në këtë shqyrtim publik, morën pjesë kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, zyrtarë komunal nga Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Menaxhimin e Emergjencave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, UNDP-ja,

UNHABITAT-i, përfaqësues të fshatrave dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Kryetari Begaj, e vlerësoi si të rëndësishëm Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), ndërsa edhe vlerësimin e rreziqeve, po ashtu e cilësoi si shumë të rëndësishëm, përfshi edhe kontributin e të gjithëve, që japin në këtë drejtim, e në veçanti nga organet profesionale, e bëjnë PZHK-në, një dokument shumë të kompletuar që do të orientoj zhvillimin e Malishevës në të ardhmen.

Për këtë pjesë të PZHK-së, folën edhe Vigan Berani, zyrtar i UNHABITAT-it dhe Yusuke Hara nga OSBE, sipas të cilëve ky dokument strategjik i përgjigjet nevojave të qytetarëve, ndërsa tejkalimi apo parandalimi i rreziqeve, gjithashtu e bënë më të kompletuar këtë plan zhvillimor.

Më pas, PZHK-në dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis, e prezantoi Valdete Morina, zyrtare e drejtorisë së urbanizimit dhe udhëheqëse e hartimit të këtij plani.

Ndërsa, Njazi Miftari, zyrtar i departamentit të menaxhimit të emergjencave, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, foli për rëndësinë e këtij dokumenti, për objektivat e vlerësimit të rreziqeve, zvogëlimin e rreziqeve dhe mënyrat e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë e mundshme. Po ashtu edhe një përfaqësuesja e UNDP-së, Zana Hoxha, foli për dëmet nga vërshimet e fundit në Malishevë, si një shembull konkret i rreziqeve, ku sipas saj, vërshime të cilat janë shkaktuar nga hedhja e mbeturinave në përroska dhe ndërtimet ilegale pranë lumenjve. Sipas saj, me investime të vogla, mund të parandalohen rreziqet.

Zyrtari i Drejtorisë së Emergjencave, Halit Mazreku, e prezantoi planin komunal të veprimit, në rastet emergjente, kapacitetet komunale, si dhe në fund dha edhe rekomandimet që dalin nga ky plan.



KPF shqyrtoi projekt buxhetin komunal për vitin 2017

Malishevë, 20 shtator

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i drejtua nga kryesuesi i KK të Malishevës, Aziz Thaçi, ka mbajtur mbledhjen e nëntë të radhës për këtë vit, ku ka shqyrtuar dhe më pas e ka rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të kuvendit, projekt buxhetin për vitin 2017. Po ashtu KPF, ka dhënë edhe disa rekomandime tjera për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Projekt buxhetin për vitin 2017, para anëtarëve të komitetit, e ka prezantuar drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, Vesel Krasniqi. Anëtarët e komitetit, e kanë rekomanduar këtë projekt buxhet, por kërkuan që projekt buxheti të shkojë në dy lexime në Kuvendin e Komunës, në mënyrë që projekt buxheti të jetë sa më i kompletuar dhe anëtarët e kuvendit të kenë më shumë hapësirë për shqyrtimin e buxhetit para miratimit të tij.

KPF, gjithashtu ka shqyrtuar dy raporte të drejtorisë për arsim dhe edukim, atë përfundimtar të vitit shkollor 2015/2016 dhe raportin për fillim vitin shkollor 2016/2017. Këtë raport, para anëtarëve të KPF-së, e ka prezantuar, drejtori i arsimit në Malishevë, Avdi Morina.

Për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës, është rekomanduar edhe raportin gjashtëmujor (janar-qershor 2016) i punës së drejtorisë për shëndetësi, raport të cilin e ka prezantuar drejtori i drejtorisë së shëndetësisë, Hajdin Berisha.

KPF, për mbledhjen e ardhshme ka rekomanduar edhe ndryshimet në Statutin e Komunës, në Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës dhe rekomanduan për kuvend, një kërkesë të një qytetari për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Drejtorët e shkollave, të pakënaqur me furnizimin me libra në shkolla

Malishevë, 20 shtator

Sot u mbajt mbledhja me Aktivin e Drejtorëve të thirrur nga Drejtoria e Arsimit dhe Edukimit në Malishevë, e cila u mbajt në javën e tretë të fillimit të vitit shkollor 2016. Drejtori i DKAE- së z. Avdi Morina para Aktivit të Drejtorëve pasqyroj angazhimet e Qeverisë Komunale dhe të Drejtorisë së Arsimit për ditët e para të punës së procesit edukativo arsimor.



Ai në pika të përgjithshme paraqiti para të pranishmëve angazhimet e Drejtorisë së Arsimit në raport me sistemin e kuadrit arsimor, në përputhje me nevojat e plotësimit të rekomandimeve për shpalljen e vendeve të punë , aty ku nuk janë të kualifikuar. Po ashtu u zotua që të bashkëpunoj ngushtë me autoritetet e MASHT dhe SIA në Gjakovë për të definuar angazhimet e mësimdhënësve në përputhje me Kualifikimin Kombëtar.

Nga të pranishmit u diskutuan kërkesa të cilat menaxhmenti shkollor kërkon, të i realizoj për të plotësuar nevojat e shkollave dhe komunitetit shkollor. Po ashtu u prek edhe fusha e cilësisë e cila do të jetë prioritet i DKA-ës që të realizohet një proces cilësor edukativo arsimor.

Nga drejtorët e shkollave u paraqitën shqetësime të shumta dhe rreth furnizimit të vonuar me libra për nxënësit në komunën e Malishevës . Pra kanë kaluar më shumë se dy javë dhe ende nuk janë kryer furnizimet me libra falas për nxënësit e komunës së Malishevës.

Nga të pranishmit u diskutuan edhe aspekte të tjera të zhvillimeve edukativo arsimore në komunën e Malishevës.

Megan DiGirolamo, nderohet për punën e saj në arsimin malishevas

Malishevë, 20 shtator

Megan DiGirolamo, është anëtare e misionit diplomatik të paqes nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe si vullnetare, për disa vite ka shërbyer në shkollën e fshatit Panorc, duke ju mësuar gjuhën angleze, nxënësve të kësaj shkolle. Ajo sot e ka përfunduar misionin e saj dhe për këtë qëllim, Drejtoria për Arsim dhe Edukim, ka ndarë një mirënjohje për kontributin e saj në këtë shkollë. Megan DiGirolamo, mirënjohjen ja dha kryetari i Komunës së Malishevës Ragip Begaj.

Me rastin e përfundimit të punës së saj disa vjeçare në Panorc, Megan DiGirolamo, është pritur nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i arsimit, Avdi Morina, të cilët e kanë falënderuar për punën e saj.

Edhe Megan DiGirolamo, është shprehur e kënaqur me nxënësit e asaj shkolle, si dhe me pritjen e jashtëzakonshme të popullatës së Malishevës në përgjithësi, e në veçanti të Panorcit e Rudit.

“Këtu njerëzit të përshëndesin, të çmojnë, të respektojnë jashtë mase. Edhe nëse nuk të njohin, të përshëndesin dhe kjo është gjë e mirë. Gjithashtu pritja dhe tradita shqiptare është e jashtëzakonshme”, tha Megan DiGirolamo.



Në Ditën e Rinisë, jepen mesazhe të shumta

Malishevë, 23 shtator



Në kuadër të shënimit të muajit të rinisë në Kosovë, Dita e Rinisë, po shënohet sot në Malishevë. Në hapjen zyrtare të kësaj dite, u dhanë mesazhe për të rinjtë malishevas. Në këtë hapje zyrtare, krahas të rinjve dhe organizatave rinore, morën pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoti, të cilët përveç përshëndetjeve, dhanë mesazhe të shumta, për luftimin e dukurive negative, për orientim në karrierë, për ruajtjen e traditës dhe kulturës shqiptare.

“Ne po mundohemi që ti mbështesim aktivitetet rinore dhe të krijojmë infrastrukturën e nevojshme për të rinjtë, në mënyrë që ju të keni mundësi ti tregoni vlerat e vërteta. Krahas ecjes me kohën dhe zhvillimeve tjera, ju duhet ta ruani dhe ta kultivoni edhe traditën dhe kulturën tonë mijërvjeçare. Po ashtu, ju bëj thirrje, që ti luftoni dukuritë negative dhe të ecni me trenin e jetës dhe mos lejoni që ky tren të dal nga binarët. Ju jeni nismëtarët e luftimit të dukurive negative dhe brezat e ardhshëm, do të mburren me juve. Urime Dita e Rinisë dhe shumë suksese në jetë”, ka thënë në fjalën e tij, kryetari i Komunës së Malishevës, me rastin e hapjes zyrtare të Ditës së Rinisë në Malishevë.

“Për të pasur sukses në jetë, ju duhet të orientoheni që tani në karrierë. Gjithashtu, ruajtja e traditës dhe kultivimi i vlerave dhe kulturës, ju garanton suksesin tuaj në jetë. Ne e kemi për detyrë të punojmë për ju, të krijojmë kushte për ju, dhe ju këtë angazhim të shoqërisë për ju, duhet ta tregoni me suksesin tuaj. Ju jeni e ardhmja dhe perspektiva e vendit varet nga ju”, ka thënë deputeti i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoti, duke ju drejtuar të rinjve të Komunës së Malishevës.

Më pas, aktivitetet për ditën e sotme filluan me një debat me të rinjtë, pikërisht me këtë temë, për orientim në karrierë dhe arritjen e sukseseve grupore dhe jo vetëm individuale. Më pas aktivitetet do të vazhdojnë sipas agjendës së paraparë, ku parashihen shumë aktivitete, kulturore, argëtuese, sportive dhe të cilat do të përfundojnë me një pasdite muzikore në parkun e qytetit.



Gjatë javës pritet të përfundojnë disa projekte

Malishevë, 26 shtator

Gjatë kësaj jave, pritet të përfundojë realizimi i disa projekteve kapitale, si rrugë, një aneks shkollor dhe disa projekte do të fillojnë të realizohen, krahas projekteve tjera që janë në realizim e sipër. Kështu u tha nga drejtorët e drejtorive, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të cilën e drejtoi nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku.

Sipas Drejtorisë së Urbanizimit, gjatë kësaj jave, pritet të përfundojë riparimi i aneksit të shkollës në Mirushë, dy fusha sportive në shkolla, rrugët në Dragobil dhe Panorc, të cilat janë në fazën finale, ndërsa ka filluar edhe ndërtimi i trotuarit në Drenoc. Po ashtu, janë duke vazhduar projektet tjera, si në rrugë, kanalizime dhe projekte tjera, kryesisht në infrastrukturën e përgjithshme.

Edhe Drejtoria e Bujqësisë, ka bërë të ditur se po vazhdohet me kryerjen e detyrave të përditshme në shërbim të bujqve, përderisa po vazhdohet edhe me realizimin e projekteve në përkrahje të bujqve malishevas, si në furnizim me makina mjelëse, pastaj në proces e sipër është edhe subvencionimi për mbjelljet vjeshtore.

Në këtë mbledhje u dha vërejtje për mosfurnizim të mjaftueshëm me tekste shkollore, ku drejtoria i ka evidentuar të gjitha mungesat e teksteve shkollore dhe ka kërkuar furnizim të shpejtë me tekste nga ana e ministrisë së arsimit.

Në fushën e ekonomisë, buxhetit dhe financave, drejtoria e ka përgatitur projektin buxhetin dhe ai pritet të diskutohet në dy dëgjime në Kuvendin e Komunës, gjatë kësaj jave, pasi paraprakisht janë kryer edhe dëgjimet publike.

Po ashtu edhe procesi i vaksinimit të kafshëve kundër sëmundjes gungore, është duke ecur mirë dhe deri më tani, kafshët janë vaksinuar në 34 fshatra, ndërsa i tërë vaksinimi pritet të përfundojë deri në fund javës.



Filloi asfaltimi i rrugëve në Panorc

Malishevë, 27 shtator



Komuna e Malishevës, në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme, e në veçanti të asaj rrugore, sot ka filluar asfaltimin e rrugëve brenda fshatit Panorc. Asfaltimin e rrugëve, e kanë inspektuar edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, të cilët janë ndarë të kënaqur me kryerjen e punimeve në këto rrugë.

Kryetari Begaj dhe drejtori Morina, i kanë uruar banorët e fshatit Panorc për asfaltimin e rrugëve. “Qëllim dhe obligim i yni është krijimi i kushteve më të mira për jetesë të të gjithë banorëve të Komunës së Malishevës dhe gradualisht, jemi duke e arritur këtë, pasi jemi duke investuar pa u ndalur në infrastrukturën në përgjithësi”, tha kryetari Begaj.

Ndërsa kryetari i fshatit Demir Bajra, e ka falënderuar komunën për këtë investim, shumë domethënës për të gjithë banorët, pasi pavarësisht faktit që rruga kryesore ka qenë e rregulluar, lagjet e fshatit kanë pasur problem në qarkullim për shkak të rrugës së dobët dhe të ngushtë.

Në fshatin Panorc, sipas drejtorit të urbanizmit Ahmet Morina, janë hapur, zgjeruar, dhe tani po asfaltohen afro dy kilometra rrugë, brenda lagjeve, të cilat tanimë janë lidhur me rrugën kryesore. “Rruga e hapur, fillon nga shtëpia e ish shtabit lokal të UÇK-së, dhe vazhdon deri në rrugën kryesore, duke ju mundësuar qasjen në rrugë të gjitha lagjeve”, tha drejtori Morina.

Të gjitha lagjet e Drenocit, do të lidhen në rrjetin e kanalizimit

Malishevë, 28 shtator

Komuna e Malishevës, ka filluar sot implementimin edhe të një projekti kapital dhe me shumë rëndësi për jetesë të banorëve të fshatit më të madh, Drenocit. Sot filluan punimet në ndërtimin edhe të dhjetë kilometrave të rrjetit të kanalizimit, të disa lagjeve, të cilat do të lidhen me rrjetin kryesor të kanalizimit në fshat.



Fillimin e punimeve e kanë parë nga afër, drejtori i urbanizmit Ahmet Morina, ai shërbimeve publike, Milazim Morina, si dhe drejtoresha për kulturë, Blerta Krasniqi, të cilët i kanë përgëzuar banorët për realizimin e këtij projekti me rëndësi për jetesën e tyre, pasi ujërat e zeza, do të largohen përgjithmonë nga lagjet e tyre.

Sipas drejtorit të urbanizmit, Ahmet Morina, përmes këtij projekti, do të rregullohet përfundimisht rrjeti i kanalizimit, ndërsa në të njëjtën kohë, është duke u punuar edhe në gypin kryesor, ku lidhen të gjitha lagjet, duke filluar nga fshati Vërmicë, ndërsa më pas do të vazhdohet me ndërtimin e këtij kanalizimi, deri në derdhjen në kolektorin kryesor të ujërave të zeza.

Banorët e Drenocit, e kanë falënderuar Komunën e Malishevës, për realizimin e këtij projekti, me rëndësi të madhe, që ndikon direkt në mirëqenien e tyre, pasi ndërtimi i sistemit të ujësjes, ka bërë që edhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit, të jetë i domosdoshëm.

Po ashtu, sipas drejtorit Morina, në këtë fshat, janë duke u realizuar edhe projekte tjera, e në mesin e tyre edhe trotuari, i cili në veçanti, do t'iu mundësoj nxënësve të ecin lirshëm nga shtëpitë e tyre, deri në shkollën e fshatit.

KK i Malishevës mbajti mbledhjen e nëntë të rregullt

Malishevë, 28 shtator

Kuvendi i Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryesuesi Aziz Thaçi, sot ka mbajtur mbledhjen e nëntë të rregullt të saj, për këtë vit. Në këtë mbledhje, KK i Malishevës, ka shqyrtuar projekt buxhetin 2017-2019, si dhe ka shqyrtuar edhe dy raporte të drejtorisë së arsimit.

Projekt buxhetin komunal 2017-2019, pata anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Malishevës, e ka prezantuar drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Vesel Krasniqi. Drejtori Krasniqi, në mënyrë të detajuar e ka prezantuar hartimin e projekt buxhetit, duke filluar nga qarkorja e parë, pastaj, dëgjimet publike e deri në prezantimin e buxhetit para Kuvendit të Komunës. Ndërsa anëtarët e kuvendit, kanë debatuar rreth buxhetit, kryesisht për investimet kapitale, ku i kanë dhënë propozimet e tyre. Ky projekt buxhet u lexua në dëgjim të parë, ndërsa të premtën, pritet të lexohet edhe versioni përfundimtarë, para miratimit të tij nga ana e kuvendit.



Po ashtu në mbledhjen e sotme, është prezantuar raporti i përfundimit të vitit shkollor 2015/2016 dhe përgatitjet e fillimit të vitit shkollor 2016/2017, raporte të cilat i prezantoi drejtori i arsimit, Avdi Morina. Morina, i ka prezantuar të gjitha të arriturat dhe sfidat e që ka drejtorja, në rritjen e cilësisë së arsimit. Më pas, edhe anëtarët e KK të Malishevës, kanë debatuar rreth gjendjes në arsim, ku të gjitha diskutimet ishin të orientuara në rritjen e cilësisë, duke i

eliminuar defektet që mund të jenë në shkollat e Komunës së Malishevës.

KK i Malishevës, gjithashtu, ka shqyrtuar kërkesën e një qytetari nga Malisheva, për ndërrim destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, kërkesë e cila është miratuar.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, mbledhjen e radhës do ta mbajë të premten më 30 shtator, kur edhe do të shqyrtohet Rregullorja për Tatimin mbi Pronën dhe Projekt Buxheti 2017-2019, lexim i dytë.

Kuvendi i të Rinjve, mbajti mbledhjen e gjashtë të radhës

Malishevë, 29 shtator

Kuvendi i të Rinjve të Malishevës, i drejtuar nga kryetari i saj, Lulzim Buzhala, ka mbajtur sot mbledhjen e gjashtë të rregullt, ku janë diskutuar një varg çështjesh, që kanë të bëjmë me rininë dhe planifikimet e këtij kuvendi për projektet e ardhshme.

Në këtë mbledhje, u diskutua për projektet që pritet të jetësohen në të ardhmen nga ana e Kuvendit të të Rinjve të Malishevës.

Gjatë diskutimeve në këtë mbledhje, u kërkua që të punohet më shumë në socializmin e të rinjve dhe angazhimin e tyre, sidomos të të rinjve në shkollat e mesme, si dhe të rinjtë tjerë, që jetojnë në vendbanime ku mungojnë aktivitetet rinore.

Po ashtu në këtë mbledhje u njoftua edhe për angazhimet e KRM (Kuvendi i të Rinjve të Malishevës), në aktivitetet rinore, siç kanë qenë “shkolla verore”, “Dita e Rinisë” dhe pjesëmarrja aktive në debatet për Planin Zhvillimor Komunal, hartimin e projekt buxheti komunal dhe aktivitete tjera, ku KRM ka dhënë kontributin e vet, duke u angazhuar në rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje.



Një delegacion nga Sunderni, po qëndron në Malishevë

Malishevë, 30 shtator



Nga sot e premte, në Komunën e Malishevës, po qëndron një delegacion nga qyteti i Sundern-it nga Gjermania. Këtij delegacioni po i prinë i pari i Sundernit, z.Rahpl Brodel, i shoqëruar edhe nga drejtori për arsim i këtij qyteti dhe përgjegjësi për menaxhimin e ujërave. Delegacioni, është pritur nga i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj me bashkëpunëtor, ndërsa kjo vizitë zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë, tash e disa vite me radhë.

Pas pritjes nga kryetari i komunës, delegacioni ka marrë pjesë edhe në seancën e rregullt të Kuvendit të Komunës së Malishevës, ku edhe ka mbajtur një fjalim rasti. “Ne si popuj kemi një histori të përbashkët, pasi pas luftës, ne jemi ndihmuar nga miqtë tanë, dhe ashtu sikur kemi pasur ne nevojë për miq, ashtu keni nevojë edhe ju. Bashkërisht mund të punojmë dhe të shkëmbejmë përvojat tona”, tha mes tjerash kryetari Sundernit, Rahpl Brodel.

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, e ka falënderuar delegacionin nga Sunderni për vizitën në Malishevë, si dhe i ka falënderuar për bashkëpunimin e ndërsjellë mes dy qyteteve. “Ne, nga lufta jemi dalë një vend tërësisht i shkatërruar, por me ndihmën e miqve ndërkombëtar, jemi ngritur, e në veçanti nga përkrahja e popullit gjerman, dhe për këtë ne ju falënderojmë dhe ju jemi mirënjohës”, tha Begaj.

Më pas, delegacioni nga Sunderni, të shoqëruar nga kryetari Begaj, kanë vizituar Qendrën e Kompetencës, gjimnazin, çerdhen për fëmijë, njësinë e Hidroregjonit jugor dhe më pas edhe disa punime në ndërtimin e ujësjellësit për dymbëdhjetë fshatra të Malishevës.

Gjatë kësaj vizite tre ditore, do të vizitohen edhe vende tjera ku realizohen projekte të ndryshme, si dhe vendet turistike në Komunën e Malishevës dhe në vend.

Qëllimi i kësaj vizite, është vazhdimi i bashkëpunimit me dy qyteteve dhe shkëmbimi i përvojave, sidomos në fushën e arsimit dhe të menaxhimit të ujërave, pasi Sunderni, ka përvojë të mirë në këto dy fusha.



Në këtë pjesë të Gjermanisë, jetojnë dhe punojnë një numër i madh i shqiptarëve, sidomos nga Komuna e Malishevës, ku edhe është e formuar shoqata shqiptaro-gjermane, të cilën e drejton z.Fadil Bytyçi nga Shkoza e Malishevës, i cili edhe është iniciator i bashkëpunimit mes dy qyteteve.

KK i Malishevës, nuk ka miratuar projekt buxhetin 2017-2019

Malishevë, 30 shtator

Kuvendi i Komunës së Malishevës, sot ka mbajtur seancën e dhjetë të rregullt, në të cilën është shqyrtuar në lexim të dytë, projekt buxheti komunal 2017-2019. Anëtarët e Kuvendit të Komunës, me shumicë të votave, nuk e kanë miratuar këtë projekt buxhet.

Nga 30 anëtar prezent që ishin në këtë seancë, 14 anëtar kanë votuar për, ndërsa 16 kanë votuar kundër këtij projekt buxheti.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, pritet që në vazhdim të javës së ardhshme, të shqyrtoj mundësinë e mbajtjes së një mbledhje tjetër, për ta shqyrtuar edhe njëherë projekt buxhetin.